



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 52, paragrafi 2 i Rregullores së Kuvendit, pas interpelancës së mbajtur lidhur me situatën dhe gjendjen financiare në ndërmarrjet publike të Telekomit dhe të Postës së Kosovës, në seancën plenare të mbajtur më 8 qershor dhe 12 korrik 2018, me propozim të GP të Lëvizjes Vetëvendosje dhe GP të Lidhjes Demokratike të Kosovës miratoi këtë:

REZOLUTË

1. Qeveria menjëherë pas miratimit të kësaj rezolute të fillojë nga zbatimi i të gjitha detyrimeve nga Ligji për ndërmarrjet publike, duke anuluar çdo vendim tjetër që bie ndesh me këtë ligj.
2. Qeveria 15 ditë nga miratimi i kësaj rezolute të ngrejë shtabin e menaxhimit të krizës në këto dy ndërmarrje me qëllimin ristrukturimin e thellë të veprimtarisë biznesore, të burimeve njerëzore dhe të planit të investimeve. Ristrukturimi i Telekomit të Kosovës të përfshijë ngrirjen e të gjitha pozitive udhëheqëse në Telekom dhe angazhimit të një institucioni kompetent për menaxhimin emergjent të kësaj ndërmarrjeje deri në rikonsolidimin e plotë të saj.
3. Përbërja e shtabit të krizës, termat e referencës dhe profili i anëtarëve të përcaktohet në bashkëpunim me Komisionin për Zhvillim Ekonomik dhe Qeverisë së Kosovës.
4. Të tërheqë anëtarët aktualë të Bordit të emëruar pa bazë profesionale dhe të propozojë anëtarë me integritet të lartë dhe profesionistë me përvojë të gjatë në fushën e telekomunikacionit, financave dhe administrim të ndërmarrjeve.
5. Auditori i përgjithshëm, menjëherë pas miratimit të kësaj rezolute, të fillojë auditimin e performansës dhe auditimin e financave të Telekomit dhe Postës së Kosovës.
6. Qeveria, në bashkëpunim me Kuvendin e Kosovës, të shqyrtojë pas ristrukturimit të thellë të strukturës organizative të Telekomit moratoriumin për pagesën e dividendës nga Telekomit i Kosovës për një periudhë dyvjeçare dhe monitorimin në punësim në Telekomin e Kosovës.
7. Qeveria e Kosovës, si aksionari kryesor, duhet të tërhiqet nga marrëveshja abuzive e ish-drejtorit të Telekomit me kompaninë Z-Mobile.

8. Kryeministri t'i raportojë Kuvendit jo më larg se 30 ditë nga miratimi i kësaj rezolute për masat e marra në Telekomin dhe në Postën e Kosovës.

9. Në afat prej një muaji pas dorëzimit të raportit, sipas pikës 8, Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal të ndërmarrë një shqyrtim gjithëpërfshirës për të analizuar të gjeturat e raportit të Qeverisë, përfshirë këtu ftesën për raportim në komision të zyrtarëve që komisioni e sheh të arsyeshme, dhe të njoftojë Kryesinë e Kuvendit.

10. ARKEP të zbatojë ligjin duke njoftuar sa më parë lidhur me tarifat e reja të licencimit të Telekomit të Kosovës.

11. Qeveria të bëjë publike të gjitha dokumentet lidhur me titullin e pronësisë së kodit telefonik +383 dhe ARKEP të marrë masa për pezullimin e përdorimit të kodit të Serbisë +381.

12. Kuvendi i Republikës së Kosovës fton Prokurorinë e Kosovës që të vendosë në prioritet hetimin e kontratës me Dardanfon (me tej Z-mobile).

Nr. 06-R- 013

Prishtinë, 12. 7. 2018

Kryetari i Kuvendit:


Kadri VESELI

Rezoluta u dërgohet:

- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Grupeve parlamentare dhe
- Arkivit të Kuvendit.